


RAPORTI VETËVLERËSIMIT

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

2019-2020



Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Adresa: L.1, Rruga e Currilave, Durrës

Adresa: Kampusi i Ri Universitar, Rr. Miqësia

Email: (njsbc@uamd.edu.al)

Website: (www.uamd.edu.al)

PËRMBAJTJA

ÇFARË ËSHTË VETËVLERËSIMIT _____	3
REALIZIMI _____	3
PËRMBAJTJA _____	3
QËLLIMI _____	3
VETËVLERËSIMI NË UAMD _____	4
 HISTORIKU I UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS _____	5
 ORGANIZIMI I INSTITUCIONIT _____	9
BAZA LIGJORE DHE AUTONOMIA NË ORGANIZIMIN E BRENDSSHËM _____	9
BASHKËPUNIMI ME KOMUNITETIN E QYTETIT _____	12
NDËRKOMBËTARIZIMI DHE PARTNERITETET _____	13
PROJEKTET _____	13
 RESURSET E INSTITUCIONIT _____	21
 KURRIKULA _____	23
 MËSIMDHËNIA DHE KËRKIMI SHKENCORË _____	28
 STUDENTËT _____	33
SHËRBIMET NDAJ STUDENTËVE - SEKRETARIA MËSIMORE _____	36
 PIKA TË FORTA TË INSTITUCIONIT _____	1

ÇFARË ËSHTË VETËVLERËSIMIT

Realizimi

Vetëvlerësimi është faza e parë e vlerësimit. Raporti i Vetëvlerësimit, i cili krijon një përmbledhje të të dhënave të Institucionit duke u bazuar në fushat kryesore të cilësisë, është një proces me shumë hapa. Ky raport jep kontribut në mjetet dhe mënyrën se si menaxhohet ruajtja dhe zhvillimi i cilësisë. Raporti i Vetëvlerësimit mbledh evidencat me anë të së cilave vlerësohet cilësia e shërbimit dhe mundëson analizimin e nevojave dhe vendosjen e synimeve për zhvillimin e cilësisë.¹

Përmbajtja

Raporti i Vetëvlerësimit përmban të dhëna të plota mbi pesë fushat kryesore akademike dhe procedurale të nxjerra nga Standardet Shtetërore të Cilësisë. Organizimi Institucional ; Resurset e Institucionit ; Kurrikula ; Mësimdhënia dhe Kërkimi Shkencorë ; Studentët.²

Qëllimi

Vetëvlerësimin e Brëndshëm të Cilësisë nuk e konsiderojmë si një akt të veçantë por si një proces të vazhdueshëm, i cili ka për qëllim zhvillimin e cilësisë përmes përmirësimit të sistemit të kontrollit të brëndshëm, miratimit të treguesve të cilësisë në kuadër të “vlerësimit të brëndshëm”, si dhe përmes aplikimeve përkatëse të tyre, duke respektuar çdo hap të nevojshëm për këtë proces dhe për çdo proces tjetër që lidhet me cilësinë.

RVB shërben njëkohësisht edhe për të rikonceptuar strategjinë, objektivat, vizionin dhe misionin e fakultetit me synimin për të ngritur në një nivel akoma më të lartë shkallën e performancës dhe efektivitetin e punës për të garantuar vazhdimësinë e sigurimit të cilësisë.



“QUALITY ... is everyone's responsibility”

-W. Edwards Deming

¹ Rregullorja e Sistemit të Brëndshëm të Sigurimit të Cilësisë (Dokumenti I)

² Lista e Evidencave (Dokumenti II)

Vetëvlerësimi në UAMD

Në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës sigurimi i cilësisë është një prioritet.

Ne jemi të vetëdijshëm se është pikërisht sigurimi i cilësisë në mësimdhënie e mësimnxënie, në organizim strukturor të menaxhimit akademik e financiar të institucionit, në veprimtaritë e stafit akademik e administrativ, duke vënë në qendër gjithmonë studentët, është ajo që ka bërë që institucioni ka arritur vlerësimin më të lartë ndër IAL publike në Republikën e Shqipërisë në procesin e Akreditimit Institucional.



Gjatë vitit akademik 2020-2021 aplikua për 24 programe studimi në Master Profesional; nga këto 4 programe studimi kanë marrë vlerësimin **POZITIV** dhe janë akredituar me vlerësim të lartë me kohëzgjatje 4 (vite) akademike. Për 12 programe studimi ka përfunduar procesi i akreditimit, pritet Vendimi i Bordit të Administrimit; 8 programe studimi janë në fillim të procesit të Akreditimit.

HISTORIKU I UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës është një institucion publik i arsimit të lartë i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 801, datë 20.12.2005 “Për hapjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës”. Për herë të parë universiteti hapi dyert për studentët në vitin akademik 2006-2007 ku në bankat e tij filluan studimet universitare rreth një mijë studentë nga i gjithë vendi.³ Me hapjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Qeveria Shqiptare nuk kishte për qëllim hapjen e një institucioni të ri në vend, por hapjen e një institucioni ndryshe, i cili do të sillte eksperiencat më të mira akademike perëndimore. Filozofia e punës është “studenti në qendër të vëmendjes”, që do të thotë se gjithçka që ndodh në universitet që nga procesi mësimor, shërbimet, aktivitetet dhe mjetet janë në dispozicion ekskluziv të studentit. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet një stafi dinamik të zgjedhur dhe të përkushtuar, një ambjenti të kompjuterizuar që mundëson kontakte të vazhdueshme me botën akademike perëndimore dhe nëpërmjet veprimtarive të larmishme ekstrakurrikulare.

UAMD që në fillim punoi sipas parimeve të Kartës Evropiane duke kombinuar këtë të fundit me mënyrën e vlerësimit të sistemit amerikan. Kjo është bërë me qëllim që studenti i diplomuar në UAMD të ketë lexueshmëri dhe njohje të diplomës së tij në vende të ndryshme të botës qoftë për studime të mëtejshme, qoftë për punësim. Institucioni lëshon diploma të shkruara në gjuhën shqipe dhe angleze dhe vlerësimi shprehet sipas sistemit ECTS dhe atij amerikan.⁴



³ VKM për hapjen e Institucionit

⁴ Aplikimi i sistemit ECTS dhe USCr ne Supplementin e Diplomave

Një tjetër veçori e këtij Institucioni është fakti se ka patur gjithmonë si objektiv të jetë në lidhje të vazhdueshme me komunitetin e qytetit të Durrës-it duke tentuar gjatë gjithë kohës të krijojë ura bashkëpunimi me institucionet rajonale të zhvillimit të qytetit tonë.⁵

Në këto vite eksperiencë, UAMD ka pësuar rritje dhe transformime cilësore dhe sasiore. Sot institucioni numëron mbi 100 programe⁶ në të tri ciklet studimit, rreth njëzetë mijë studentë, rreth 300 punonjës si personel akademik me kohë të plotë të organizuar në gjashtë njësi kryesore, si më poshtë⁷:

- 1- Fakulteti i Biznesit;
- 2- Fakulteti i Shkencave Politike Juridike;
- 3- Fakulteti i Edukimit;
- 4- Fakulteti i Studimeve Profesionale;
- 5- Fakulteti i Informacionit dhe Teknologjisë;
- 6- Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën.



⁵ Marrëveshje Bashkëpunimi me institucione dhe komunitetin e Biznesit në Durrës


⁶ Lista e programeve të studimit (aktiv/riorganizuar)

⁷ Të dhënat statistikore (Aneksi I)

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, në gjithë veprimtarinë e tij synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë. Me misionin e tij, universiteti ka për qëllim: “nxitjen dhe zhvillimin e të menduarit kritik e analitik, si dhe ndjenjës së përgjegjësisë dhe angazhimit ndaj njeriut, komunitetit, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme që shqetësojnë individin dhe komunitetin”⁸

Gjatë vitit akademik 2019-2020 në historikun e UAMD-së u realizua për të parën herë procesi I mësimdhënies online. Kjo risi erdhi nga masat e marra në UAMD, në lidhje me Protokollin e Sigurisë ndaj virusit Covid 19 VKM Nr.243, datë 24.03.2020. Menjëherë pas fillimit të pandemisë, për të mos humbur Vitin Akademik 2019-2020, si edhe për të shmangur krijimin e mangësive në të nxënë të studentëve të UAMD-së, procesi i mësimdhënies u zhvillua online. “Teaching & Learning” u realizua nëpërmjet platformës “Google Classroom” dhe “Zoom Meeting”.

Këto sisteme online mundësojnë më së miri organizimin e zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, si edhe ofron një bashkëpunim dhe komunikim të ngushtë efektiv ndërmjet lektorit e studentëve. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në zbatim të përmbushjes së përgjegjësisë të përcaktuara në Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, dhe në funksion të aplikimit të “Standarteve të Cilësisë”, në situatën e gjëndjes së jashtëzakonshme shpallur nga qeveria e Republikës së Shqipërisë me VKM Nr.243, datë 24.03.2020 “Për Shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore”, NjBSC realizoi një analizë mbi realizimin e mësimdhënies në klasat virtuale.



⁸V.K.M Nr. 827 datë 11.06.2008

NjBSC konstatoi që udhëzimi i studentëve mbi aksesimin e klasave online është realizuar më së miri, në faqen web të Institucionit dhe në rrjetet sociale të UAMD gjithashtu procesi i mësimdhënies rezultoi efikas dhe cikli i leksioneve në platformën “Google Classroom” zhvillohej rregullisht në vazhdimësi.

Vihej re një frymë e ngushtë komunikimi e bashkëpunimi lektor-studentë. Lektorët tregonin impenjim, seriozitet e korrektësi në organizimin dhe lançimin e ciklit të leksioneve; gjithashtu studentët shfaqnin interes të lartë, gjë e dukshme kjo në pjesëmarrje të gjërë online, si edhe në përmbushjen e realizimin e ushtrimeve dhe detyrave të kërkuara nga lektorët. Realizimi dhe zhvillimi i procesit të mësimdhënies online rezultoi efektive në vazhdimësinë e vijueshmërinë e Vitit Akademik 2019-2020. Kjo gjë u pasqyrua më qartë në rikthimin në auditor ku, në vazhdimësi të Protokollit të Sigurisë ndaj Covid 19, procesi i mësimdhënies u zhvillua në auditore në formën e një përsëritjeje të leksioneve online, me grupe të vogla, të reduktuara studentësh, të ndarë sipas kategorive përkatëse. Zhvillimi i mësimdhënies online ishte një vlerë e shtuar në krijimin e faciliteteve përgjatë rikthimit të periudhës kohore në auditore, si në lehtësimin e përvetërvetësimit të të nxëniet të studentët, ashtu edhe në menaxhimin e leksioneve dhe seminareve të klasës nga lektorët.



(Në grafik paraqitet numri i klasave virtuale të analizuar nga NjBSC gjatë periudhës 27 Prill – 10 Maj. Përzgjedhja e rastësishme e klasave është bërë në nivel departamenti dhe për këtë arsye në FE janë vizituar me shume klasa elektronike)

ORGANIZIMI I INSTITUCIONIT

Baza ligjore dhe Autonomia në organizimin e brendshëm

Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës është krijuar me VKM Nr. 801, dt 20.12.2005 “Për hapjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”, si një Institucion Publik i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor. Universiteti ka një statut të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës në Maj të vitit 2011. Ai mbështetet në Ligjin Nr. 80, dt 22.07.2015, (në vijim LAL) në aktet nënligjore të bazuara në të, si dhe legjislacionin ekzistues në fuqi. Statuti është në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimet e universitetit, sipas të cilave UAMD të gjithë veprimtarinë e tij synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë. Statutit i nënshtrohen të gjitha njësitë dhe strukturat organizative dhe mësimore shkencore të Universitetit.⁹

Institucioni disponon rregulloren e tij të brendshme, e cila ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë mësimore-shkencore dhe administrative të Universitetit në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të tij. Ajo i shtrin efektet e saj në të gjitha strukturat, organet dhe autoritetet drejtuese, njësitë përbërëse, personelin akademik, personelin ndihmës mësimor-shkencor, personelin administrativ, studentët, etj.¹⁰

Në rishikimin dhe përmirësimin e rregullores përfshihen aktorë të ndryshëm institucionalë nga njësitë respektive, por edhe përfaqësuesit e studentëve. Mënyra se si bëhet përmirësimi dhe rishikimi i kuadrit rregullator brenda UAMD është një indikator pozitiv për mirëfunksionimin institucional.

Strukturat administrative dhe akademike sigurojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë menaxheriale dhe akademike të Universitetit. Organet kolegjiale të zgjedhura funksionojnë, sipas statutit dhe mundësojnë diskutimet, debatet dhe marrjen e vendimeve në formë gjithëpërfshirëse. Institucioni e kryen rregullisht procesin e informimit publik përmes faqes zyrtare të internetit, si dhe raportit vjetor, i cili pasqyron gjerësisht veprimtarinë akademiko-

⁹ V.K.M. Nr. 801, datë 20 dhjetor 2005

¹⁰ Rregullorja e UAMD

shkencore dhe administrative të tij i cili bëhet publik çdo fundviti, sipas Udhëzimit të Ministrit Përgjegjës të Arsimit, brenda afateve të caktuara dhe strukturës që duhet të përmbajë raportin.

UAMD bashkëpunon me organizma të tjerë nga sektori publik dhe ai privat në mbështetje të studentëve për praktikën e tyre mësimore. UAMD është pjesë e programeve të mobilitetit të studentëve dhe stafit në kuadër të partneriteteve ndërkombëtare, Institucioni ka Planin e Zhvillimit Strategjik afatgjatë me objektiva dhe tregues të qartë mbi të cilin mbështeten politikat e përmirësimit të cilësisë.

Institucioni bazohet gjithashtu në Planin e Zhvillimit Strategjik për periudhën 2016 – 2020 . Plani përcakton qartë objektivat e synuar, strategjitë për arritjen e tyre si dhe treguesit e performancës. Pjesa më e madhe e rezultateve të performancës dhe objektivave të strategjisë pasqyrohen gjatë diskutimeve dhe publikimit të Raportit Vjetor mbi Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore dhe financiare të Institucionit çdo fundviti mes drejtuesve të institucionit, stafit akademik, studentëve dhe të ftuarve të tjerë të jashtëm.¹¹

Aktualisht, me përfundimin e periudhës së shtrirjes së strategjisë, po përgatitet Plani i Zhvillimit për periudhën 2020-2025, duke vënë në dukje ato tematika që kanë nevojë të rishikohen, duke analizuar së pari arritjet e deritanishme dhe nëse aplikohet edhe çështjet e përpilizuara, si dhe duke diskutuar në tryeza të rrumbullakëta me aktorët përkatës siç edhe është shndërruar në një praktikë shumë pozitive në UAMD. Ajo do të përshtatet me sfidat aktuale në fushën e arsimit të lartë, legjisllacioni e ri, si dhe ndryshimet në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të Institucioneve të Arsimit të Lartë.

Për të përmbushur detyrimet e ndryshme administrative UAMD, bazuar në organigramën e saj, është e organizuar në drejtori, sektorë dhe degë, kurse nga aspekti akademik në fakultete dhe departamente. Pranë Rektorit, kryejnë një rol të rëndësishëm administrativ edhe 3 zëvendësrektorë, të cilët janë përgjegjës përkatësisht për: kërkimin shkencor, fushën mësimore dhe atë institucionale.

Përfaqësimi i studentëve në Senat Akademik dhe në organe të tjera kolegjale të zgjedhura garantohet në çdo rast dhe pjesëmarrja është dinjitoze dhe frytdhënëse. Institucionit ka ngritur edhe qendra me karakter mësimor-shkencor dhe kërkimor:

- Qendra për Zhvillim dhe Ekselencë (QZHE);


¹¹Planin e Zhvillimit Strategjik për periudhën 2016 – 2020

- Qendra për Edukimin në Vazhdim (QEV)
- Qendra e Trashëgimisë Kulturore Mesjetare (QTKM)

QZHE funksionon si një strukturë që përfshin të gjitha njësitet kryesore dhe bazë të fakulteteve. Qëllimi i saj është nxitja, mbështetja, organizimi, koordinimi, monitorimi dhe vlerësimi i veprimtarisë për kërkimin shkencor, ekselencë dhe zhvillim. Qendra është përgjegjëse për botimin e revistës shkencore të Universitetit “ Interdisciplinary Journal of Research and Development” e lancuar për herë të parë në vitin 2013.

QEV është njësi bazë e veçantë në strukturën akademike të UAMD në varësi të Fakultetit të Edukimit dhe funksionon në bazë të rregullores së brendshme të saj.¹² Aktivitetet kryesore të cilat zhvillohen përmes kësaj qendre janë trajnimet e mësuesve të arsimit parauniversitar sipas foramtit të përcaktuar nga MASR. QEV funksionon si qendër kërkimore dhe e publikimeve të studimeve shkencore në fushën e edukimit.

Në këndvështrimin financiar UAMD gëzon një stabilitet të provuar ndër vite. Bordi i Administrimit është organ kolegjal në të cilin marrin pjesë përfaqësues të Institucionit dhe të financuesve kryesor të Institucionit¹³



Bashkëpunimi me komunitetin e qytetit

Universiteti është pjesë e qytetit dhe dëshiron të kontribuojë më shumë për komunitetin vendor. Së bashku me komunitetin e qytetit, jo vetëm që do të lidhim më mire Universitetin me tregun e punës, por edhe do të njohim trendet dhe nevojat specifike në mënyrë që të përmirësojmë kurrikulat e studimit dhe mendimit shkencor në UAMD.

UAMD ka një zyrë specifike për monitorimin dhe ndjekjen e vazhdueshme të punësimit të të diplomuarve të tij nëpërmjet Degës së Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit. Ky monitorim kryhet duke dërguar periodikisht formularin për t'u plotësuar online nga studentët e diplomuar në adresat e tyre të e-mail përmes të cilës mbledhen informacione mbi punësimin e tyre.¹⁴ Institucioni informohet në mënyrë të vazhdueshme për zhvillimin ekonomik rajonal përmes punimeve të autorëve që prezantohen në konferencat shkencore që zhvillojnë fakultetet e tij, si dhe përmes revistave dhe raporteve që vijnë periodikisht në bibliotekën e universitetit si psh: revista "Bankieri"¹⁵, botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave¹⁶, Buletini statistikor i Qarkut Durrës¹⁷, Raport i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë¹⁸ dhe një sërë revistash shkencore që janë të profilizuara në çështjet ekonomiko - sociale. Institucioni bazohet mbi rregullat e një konkurrence të ndershme dhe të drejtë, duke u fokusuar në promovimin e vlerave të tij, cilësisë dhe informimit publik. Ai është transparent në çështje të tilla si: kriteret e pranimit të studentëve dhe tarifat e pagesës, programet e studimit të ofruara, stafin akademik dhe kriteret e punësimit, të cilat publikohen edhe në faqen e tij zyrtare të internetit duke rritur besueshmërinë dhe njohjen nga komuniteti. Në kuadër të memorandumit të mirëkuptimit dhe mbështetjes që GIZ ka ofruar për UAMD me ekspertizë të huaj dhe vendase, në FASTIP janë zhvilluar dy studime: mbi rekrutimin dhe ndërtimin e një rrjeti komunikimi sipërmarrje- studentë, si dhe mbi nevojat cilësore në sektorët e Hotelerisë dhe Ndërmarrjeve të vogla dhe të Mesme. Edhe pse ka patur disa iniciativa të tilla në fakultete të veçanta, duhet që studimet e tregut të thellohen dhe të zgjerohen më tej duke përfshirë të gjitha fakultetet e UAMD.

¹⁴Strategjia e ALUMNI

¹⁵<https://aab.al/publikime/revista-bankieri/>

¹⁶<https://aab.al/>

¹⁷<http://www.instat.gov.al/media/6466/vjetari-statistikor-rajonal-2019.pdf>

¹⁸https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_Periodike/Raporti_i_Politikes_Monetare/

Ndërkombëtarizimi dhe Partneritetet

Projektet

Procesi i ndërkombëtarizimit të njohurive përfaqëson një nga shtyllat kryesore të sistemit arsimor. UAMD ka hartuar **“Strategjinë e Ndërkombëtarizimit 2019-2021”** e cila synon që Universiteti të jetë aktor i rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik të qytetit. Kryesore për arritjen e këtij qëllimi është rritja e partneriteteve midis institucioneve të huaja të Arsimit të Lartë duke i dhënë vlera të shtuara marrëveshjeve aktuale duke arritur diplomimin e përbashkët apo të dyfsihta me universitetet partnere në kuadrin e disa programeve të studimit me inters të përbashkët.

Gjatë vitit akademik 2019-2020, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës është shpallur fitues si partner në plot 8 projekte në kuadër të programit Erasmus +, Komponenti *“Rritja e Kapaciteteve të Institucioneve të Arsimit të Lartë”* (Capacity Building in Higher Education). UAMD po zbaton projektet si më poshtë vijon:

- **Aftësi sipërmarrëse për një arsim modern në Shqipëri (ENTRAL)** Objektivi i përgjithshëm i projektit është rritja e mendësisë sipërmarrëse në Institucionet Arsimore Shqiptare (IAL dhe shkollat), për të mbështetur aftësitë e të diplomuarve që të përputhen me kërkesat e tregut të punës dhe shoqërisë moderne, duke inkurajuar metodat e mësimdhënies sipërmarrëse. Universiteti Turku, Finlandë
- **Trekëndëshi i Njohurive për një Ekonomi të Karbonit të Ulët (KALCEA)** Projekti ka për qëllim zhvillimin e strukturave që do të lehtësojnë transferimin e njohurive midis Universitetit dhe Industrisë, për të mundësuar marrjen në treg të produkteve dhe shërbimeve të reja, në përpjekje për të adresuar gjithashtu nevojat shoqërore. Kjo është kodifikuar në idenë e Trekëndëshit të Njohurive (KT) -Triangle of Knowledge. Universiteti I Athinës, Greqi
- **Forcimi I autonomies universitare dhe rritja e përgjegjshmërisë dhe transparences së Universiteteve të Ballkanit Perëndimor (TRANSPARENT-ËBUs)** Objektivi I përgjithshëm I projektit është krijimi dhe mbështetja e proceseve dhe mekanizmave për të sigurua rmenaxhim efektiv dhe për të forcuar autonominë e universitetit, rritjen e

përgjegjësisë dhe transparencës së Universiteteve në Ballkanin Perëndimor. Projekti synon të mbështesë institucionet publike dhe private të arsimit të lartë në Kosovë dhe Shqipëri për projekte të përbashkëta strukturore për qeverisjen, planifikimin strategjik dhe menaxhimin e arsimit të lartë.

- **Kolegji Ndërkombëtar I Biznesit, Mitrovicë, Kosovë**
- **Edukimi terciar gjithëpërfshirës në Ballkanin Perëndimor (IDEA)** Qëllimi I përgjithshëm I projektit është të përmirësojë aksesin, të krijojë kushte mësimore për arsimin gjithë përfshirës dhe të krijojë mundësi punësimi për student me aftësi ndryshe dhe studentët me vështirësi në të nxënë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Universiteti Polis, Shqipëri
- **Modernizimi I kurrikulës inxhinierike në energjinë e rinovueshme në universitetet shqiptare (ENGINE)** Qëllimi I projektit është modernizimi dhe ndërkombëtarizimi I programeve arsimore profesionale dhe të nivelit bachelor në Inxhinieri, për energjitë e rinovueshme në universitetet Shqiptare përmes inovacionit të kurrikulave në përputhje me zhvillimet e reja dhe kërkesën e tregut të punës. Projekt kordinohet nga Universiteti Politeknik I Tiranës, Shqipëri.
- **Bashkë-prodhimi I njohurive dhe hulumtimeve që kanë impact (U-SIA)** Objektivi I përgjithshëm është nxitja e bashkëpunimit efektiv dhe të qëndrueshëm të universitetit për shoqërinë në Shqipëri me ndikim në procesin e integritetit evropian të vendit. Projekt kordinohet nga Qendra Mesdheu, Shqipëri.
- **Zhvillimi I Programit Rajonal “Master I Përbashkët në Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Mjedisit Detar”(MEP&M)** Objektivi kryesor I këtij projekti është formimi I ekspertëve për Mbrojtjen dhe Menaxhimin e Mjedisit Detar (MEPM) në vendet partnere të Ballkanit Perëndimor (Mali I Zi dhe Shqipëri), përmes zhvillimit dhe zbatimit të kurrikulave të reja master në gjuhën angleze. Projekt kordinohet nga Universiteti i Malit të Zi, Mal i Zi.
- **Përmirësimi ekonomik i njohurive në sektorin e ushqimit duke forcuar zyrat e transferimit teknologjik në universitetet shqiptare (TTO4FOOD).** Qëllimi i projektit është përmirësimi i njohurive në sektorin e ushqimit, përmes teknologjive të reja dhe transferimit të njohurive përmes këtyre teknologjive. Projekt kordinohet nga Universiteti i studimeve “Aldo Moro”, Itali.

- Këto projekte iu mundësojnë universiteteve shqiptare të modernizojnë metodat e mësimdhënies, të krijojnë programe të reja studimi ose të përmirësojnë programet ekzistuese duke i harmonizuar me ato të vendeve të zhvilluara të BE-së, të trajnojnë stafet akademike, të përmirësojnë laboratorët, të krijojnë ose të përmirësojnë shërbimet për studentët, për sigurimin e brendshëm të cilësisë, etj.

Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, gjatë vitit akademik 2019-2020 ka vepruar në zbatim të objektivave strategjikë të “Strategjisë së Ndërkombëtarizimit 2019-2021” sipas treguesve si më poshtë vijon:

- 12 marrëveshje të reja ndër-institucionale janë nënshkruar për shkëmbim stafi dhe studentësh me universitete në vendet e BE-së (Itali, Francë, Gjermani, Spanjë, Portugali, Suedi, Turqi);
- 8 studentë kanë përfituar nga shkëmbimet semestrale pranë universiteteve të vendeve partnere të BE-së, në Bullgari dhe Letoni. Një student po studion aktualisht në nivel master në Suedi
- 3 Staf akademik dhe 3 staf administrativ kanë kryer mobilitete pranë universiteteve partnere në Bullgari dhe Çeki.
- 2.Zhvillimi i bashkëpunimit dhe nxitja e partneriteteve në nivel lokal, kombëtar, ballkanik dhe ndërkombëtar
- 18 marrëveshje të nënshkruara në nivel kombëtar (10) dhe ndërkombëtar (8 me institucione të arsimit të lartë);

Fushat e përgjithshme të marrëveshjeve të bashkëpunimit janë:

- Nxitja e bashkëpunimit për përmirësimin e punës në fusha të përbashkëta studimi dhe kërkimi, shkëmbime të botimeve akademike ose periodike, mundësia reciproke në përdorimin e bibliotekave për literaturë të pa klasifikuar, inkurajim i përdorimit të tekseve;
- Bashkëpunime në shërbim të studentëve për krijimin e mundësisë së praktikave mësimore për të integruar studimet akademike me përvojën e punës;

- Bashkëpunim dhe shkëmbime në programe ndërkombëtare të arsimit dhe kërkimit shkencor si Erasmus+;

Shkëmbim i materialeve dhe rezultateve të punës studimore e shkencore;

- Shkëmbimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore në aktivitete didaktike, në kuadër të shkëmbimit të përvojës shkëmbehen programe dhe plane mësimore për fushat me interes të përbashkët
- Shkëmbim studentësh të cikleve të ndryshme studimi për periudha semestrale studimi ose për periudha praktike mësimore;
- Shkëmbim i stafit akademik dhe administrativ;
- Mbështetje të kërkimit shkencor të orientuar drejt praktikës;
- Nxitja dhe motivimi për punime shkencore për kualifikimin dhe marrjen e titujve akademik;
- Organizimi i konferencave të përbashkëta, trajnimeve, intershipeve, seminareve, praktikave mësimore, leksioneve të hapura kurseve specifike;
- Organizim i shkollave verore për studentët;
- Janë ndarë informacione në lidhje mundësi akademike përmes kontakteve dhe rrjeteve sociale dhe faqes web të UAMD-së.

Rritja e vizibilitetit të universitetit, përmes rrjetëzimit në rrjetet universitare në rajonin e Ballkanit perëndimor, rajonit të mesdheut dhe vendeve anëtare të OSCE-së.

Përfitimet nga antarësimet në Rrjete:

- Rrjeti Frankofon Universitar (AUF) ka financuar një projekt i cili po zbatohet në Fakultetin e Biznesit;
- Rrjeti i universiteteve të Mesdheut UNIMED, ka ftuar UAMD si partner në projekte të aplikuar rishtazi dhe ka zgjeruar bashkëpunimin për shkëmbim stafi dhe studentesh nën programin e mobiliteteve.

PARTNERITETET

UAMD është përkushtuar në zhvillimin e bashkëpunimit dhe nxitjen e partneriteteve në nivel lokal , kombëtar , ballkanik e ndërkombëtar , duke synuar rivitalizimin e marrëveshjeve ekzistuese të bashkëpunimit , si dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të reja me universitete brenda dhe jashtë vendit , për të pasur një ambient favorizues e stimulues për kërkimin shkencor dhe mobilitetin e stafit akademik dhe të studentëve ; për zbatimin e projekteve që lidhen me kërkimin shkencor dhe zhvillimin e partneriteteve publik-privat me komunitete biznesi , think tank , shoqëri civile dhe komunitetin në tërësi

Në nivel kombëtar është një factor kyç partneriteti me grupet e interesit për eksplorimin e mundësive për aplikime të përbashkëta në kuadër të programeve të aderimit në BE.

Në nivel ndërkombëtar objektivat kryesorë mbeten : zgjerimi i marrëveshjeve me universitete dhe agjensi kërkimore të huaja me qëllim transferimin e dijeve dhe praktikave të mira, eksplorimin e teknikave inovative në mësimdhënie dhe transferim dijeshe dhe praktikash pozitive; shkëmbimi i stafit akademik dhe studentor për periudha të caktuara.

Në drejtim të bashkëpunimit e partneritetit në tre vitet e fundit e në vazhdim UAMD ka qenë pjesëmarrëse në shumë programe e projekte partneriteti në nivel rajonal e më gjërë. Vlen për t'u theksuar se roli i UAMD-së ka qenë në nivel lideri ose partneri në grupin e partneritetit me universitetet e tjera



(Takim me përfaqësues të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Kosovë)

Tabela nr.1: Përmbledhje e Marrëveshjeve të finalizuara në rang Kombëtar dhe Ndërkombëtar gjatë vitit 2019-2020.

Marrëveshje të finalizuara gjatë 2019-2020 në rang Ndërkombëtar	Marrëveshje të finalizuara gjatë 2019-2020 në rang Kombëtar
1-Universita Luigi Vanvitelli Italy	1- Akademia e Studimeve Albanologjike Tiranë
2-Universita Degli Studi di Perugia Italy	2 -Universiteti Bujqësor të Tiranës
3- Bielefeld University of Applied Sciences Germany	3- Fondacioni Arsimor Shqiptar FASH Tiranë
4-UniversitetiUkshinHotiKosove	4- EMS Albanian Port operator shpkDurrës
5 –Aurel Vlaicu Universita of Arad	5- Qendra Muzeore, Durrës
6- North Ossetian State University	6- New York University Tiranë
7-Universita’ degli studi di Firenze Italy	7- Drejtoria e pergjithshme e arsimit parauniversitar Durrës
8- Instambul Aydin University Turkey	8- Drejtoria e pergjithshme e arsimit parauniversitar Durrës
	9- Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor Durrës
	10- Marin Barleti University Tiranë

Tabela nr.2: Marrëveshje të lidhura me Universitete të huaja, gjatë vitit 2019

Viti 2019	Shteti	Universitetet e Huaja	Tipologjia	Afati
	Tizi Ouzou, Algjeri	Mouloud Mammeri Tizi-Ouzou University	Bashkpunim/Shkëmbime	4 vite
	Ferizaj, Kosovë	Marrëveshje Universiteti I Shkencave të Aplikuara	Bashkpunim/Shkëmbime	5 Vite
	Republika Çeke	Technical University of Ostrava	Bashkpunim/Shkëmbime	5 Vite
	Republika Çeke	Jan Evangelista Purkyně University in Ústí nad Labem	Bashkpunim/Shkëmbime	5 Vite
	Spanje	Universiteti A Coruña	Bashkpunim/Shkëmbime	4 vite
	Letoni	Universiteti I Shkencave të Aplikuara, Vīdeme	Bashkpunim/Shkëmbime	5 Vite
	Vigo Spain	University of Vigo	Bashkpunim/Shkëmbime	5 Vite
	Vigo Spain	University of Vigo	Bashkpunim/Shkëmbime	5 Vite
	Mondragon Unibertsitatea	The Faculty of Business of Mondragon Unibertsitatea	Bashkpunim/Shkëmbime	5 Vite
	Spain	University of Salamanca	Bashkpunim/Shkëmbime	4 vite
	Italia, Caserta	Università Luigi Vanvitelli	Bashkpunim/Shkëmbime	5 Vite
	Italia, Perugia	Università Degli Studi di Perugia	Bashkpunim/Shkëmbime	20 Vite
	Bielefeld, Germany	Bielefeld University of Applied Sciences	Bashkpunim/Shkëmbime	5 Vite
	Prishtinë Kosovë	Universiteti Ukshin Hoti	Bashkpunim/Shkëmbime	5 Vite
	Arad, Rumani	Aurel Vlaicu University of Arad	Bashkpunim/Shkëmbime	Pacaktuar
	Vladikavkaz, Russia	North Ossetian State University	Bashkpunim/Shkëmbime	5 Vite

Tabela nr.3: Pasqyra e aktivitetit të partneritetit të UAMD-së me universitetet e rajonit e më
gjërë gjatë tre viteve të fundit e në vazhdim është si më poshtë

Programme or initiative	Reference number	Beneficiary Organisation	Title of the project	Faculties involved at UAMD
Erasmus + CBHE	586318-EPP-1-2017-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP	University Aleksander Moisiu, Durres	Development and Implementation of the Multimedia Curriculum and Digital Television (DIMTV)	Faculty of Technology Information
Erasmus+ CBHE	573540-epp-1-2016-be-eppka2-cbhe-jp	University Aleksander Moisiu, Durres	LAW and right modules in teacher training programmes	Faculty of Education
Erasmus+ CBHE	585578-EPP-1-2017-1-ES-EPPKA2-CBHE-JP	University of Baleare Islands, Spain	IT governance in Albanian universities (ITG4AU)	Faculty of Technology Information
Erasmus+ CBHE	609786-EPP-1-2019-1-XK-EPPKA2-CBHE-JP	University Kadri Zeka, Gjilan	Qualitative development of international cooperation and project management (QUADIC)	IR&Projects Office
Erasmus+ CBHE	586300-EPP-1-2017-1-ES-EPPKA2-CBHE-SP	University of Leon, Spain	Development of Teacher Competences for a comprehensive VET system in Albania (TEAVET)	Faculty of Education
Erasmus+ CBHE	610281-EPP-1-2019-1-ALEPPKA2-CBHE-JP	University Aleksander Moisiu, Durres	Accelerating the Modernization of Western Balkan Universities through Virtual Technology	Faculty of Technology Information
Erasmus+ CBHE	598550-EPP-1-2018-1-HR-EPPKA2-CBHE-JP	University of Split, Croatia	Capacity Building for Blue Growth and Curriculum Development of Marine Fishery in Albania (ALMARS)	Faculty of Professional Studies
Erasmus+ CBHE	610360-EPP-1-2019-1-DE-EPPKA2-CBHE-JP	Technical University of Dresden, (TUD) Germany	Virtual Exchange between Albanian and European Universities (VALEU-X)	Faculty of Technology Information
INTERREG IPA CBC ITALI - SHQIPERI - MALI ZI	229	Ministry of Education, Montenegro	High Technical Specialists in Key Training eTechnologies (KET) (HISTEK)	Faculty of Business
INTERREG-BALKAN-MEDITERAN	BMP1/1.3/2616/2017	University Aleksander Moisiu, Durres	Entrepreneurial Learning Exchange Initiative for Sustainable Hospitality SMES in the BALKAN-MEDITERRANEAN Region	Faculty of Business
ERDF + IPA FUNDING	4MED-123-009	Emilia Romagna Region	Mediterranean Innovation Strategy for transnational activity of clusters and networks of the Blue Growth (MISTRAL)	Faculty of Business

RESURSET E INSTITUCIONIT

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

UAMD përmbush plotësisht detyrimet ligjore për plotësimin e njësive bazë me staf akademik efektiv me grada e tituj .Institucioni publikon në faqen zyrtare të internetit organigramën. Ai ndjek procedurë transparente të rekrutimit të stafit akademik dhe jo akademik në përputhje me LAL dhe akteve të tjera nënligjore, Rregulloren (nenet 26, 27, 28) dhe Statutin e Universitetit (neni 33).

Personeli akademik i UAMD mund të jetë me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Ky personel klasifikohet në 3 kategori : Profesorë, Lektorë dhe Asistent-lektorë.Duhet theksuar se në rastet e stafit akademik efektiv që nuk kanë fituar gradën Dr. vetë institucioni i ka mundësuar trajnime efektive pranë Qendrës për Edukim në Vazhdim.Në rekrutimin e stafit akademik me kontratë vihet re një rritje e profesionalizmit të kandidatëve që tregon dhe reputacionin e mirë që Institucioni ka krijuar .Vlen për të përmendur gjithashtu një ulje në raportin staf akademik-studentë për m2.Ky reduktim vjen si pasojë e rritjes së numrit të stafit akademik, por edhe aktivizimit të godinës së re në Kampusin e Universitetit. Për vitin akademik 2019-2020, rezultojnë të punësuar për të dy semestrat, 219 dhe 210 lektorë përkatësisht.

Sipas nevojave të UAMD për rekrutim të stafit, shpallet konkursi dhe publikohet njoftimi për vendet vakante në UAMD në faqen zyrtare të Prokurimeve Publike. Njoftimet publikohen në faqen zyrtare të Universitetit së bashku me formularët e aplikimit.Për cdo vend vakant të publikuar përshkruhet pozicioni i punës, kriteret që duhet të përmbushen nga aplikanti, dokumentacioni i kërkuar, afati i aplikimit. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për personel akademik dhe ndihmës mësimor-shkencor, propozohen nga Njësia Bazë përkatëse.

Vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza, atë të vlerësimit të dosjeve të aplikantëve, e cila përbën 70% të vlerësimit dhe atë të intervistës përballë komisionit të rekrutimit, e cila përbën 30% të vlerësimit ad hoc nga Dekani në përputhje me Rregulloren e Universitetit dhe LAL. Komisionet e vlerësimit të kandidaturave për secilin specialitet marrin në shqyrtim paketat e

aplikimit të kandidatëve pranë DBNJ, verifikojnë përputhshmërinë e informacionit të formularit të aplikimit me dokumentacionin e paketës. Komisionet e vlerësimit të kandidaturave shqyrtojnë paketat e aplikimit sipas formularit përkatës e hartojnë listën e kandidaturave, sipas pikëve të fituara, në rendin zbritës për çdo specialitet dhe e paraqesin atë pranë dekanatit. Të gjithë kandidatët njoftohen nga DBNJ për intervistën, me shkresë zyrtare (me postë) dhe me e-mail. Njoftimi publikohet në ambientet e universitetit. Lista përfundimtare e kandidatëve miratohet nga dekani, i cili përcjell tek Rektori emrat fitues dhe renditjen e kandidatëve. UAMD punëson personel akademik me kohë të pjesshme sipas nevojave të Universitetit, në përputhje me Rregulloren e tij dhe LAL. Universiteti ka një çelës për vlerësimin e gjithë procedurës së konkursit që nga vlerësimi i paketës së aplikimit (dosjes personale) deri në intervistën me gojë. Gjatë këtyre procedurave janë konsideruar kandidatët e kualifikuar në Universitete të njohura ndërkombëtare. DBNJ përditëson në mënyrë të vazhdueshme dosjen e stafit akademik.

UAMD ndjek një politikë integruese dhe ndërkombëtarizuese për personelin dhe studentët e tij, ku vetëm në katër vitet e fundit ka shkëmbyer staf në kuadër të komponentit të mobiliteteve (nën programin Erasmus+ International Credit Mobility-ICM) kundrejt Universiteteve partnere Evropiane. Personeli akademik dhe administrativ ka qenë pjesë e shkëmbimeve të komponentit të mobiliteteve duke sjellë në institucion përfitime profesionale dhe duke zgjeruar rrjetin e bashkëpunimeve si rrjedhojë e këtyre mobiliteteve (përkatësisht 117 personel akademik dhe administrativ).

Risi është gjithashtu krijimi i një mekanizmi vlerësimi të vazhdueshëm e periodik për personelin në përputhje me rregulloren e UAMD, mekanizëm ky i organizuar në tre nivele të cilat përfshihen në Raportin Vjetor të vlerësimit.

Studentët gjithashtu janë pjesë e vlerësimit të personelit akademik. Çdo vit studentëve iu shpërndahen pyetësorë nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë, lidhur me performancën e personelit akademik. Pyetësorët plotësohen në mungesë të personelit akademik dhe ruajnë anonimin e studentit. Rezultatet e anketimit nga studentët pasqyrohen në Raportin e Performancës së Personelit Akademik.

KURRIKULA

Oferta akademike është në përputhje me misionin dhe vizionin e Institucionit ,si dhe me Planin e Zhvillimit Strategjik të tij¹⁹. UAMD siguron informim publik të ofertës akademike nëpërmjet zyrave përgjegjëse dhe paraqitet në mënyrë të përditësuar në faqen zyrtare të internetit.

Oferta akademike e UAMD përqëndrohet kryesisht në këto fusha strategjike: Shkenca Juridike, Financë, Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Mësuesi, Transport, Menaxhim, Turizëm, Infermieri, Arsim Profesional etj. Disa programe studimi u janë përshtatur kërkesave të tregut në bashkëpunim me komunitetin e biznesit. Ato ofrojnë kombinim të vazhdueshëm të njohurive teorike dhe praktikës në sektorin publik dhe privat nëpërmjet studimeve profesionale 2-vjeçare në FSP.

Institucioni është kujdesur që programet e studimit që ofron të rishikohen në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi²⁰. Si rezultat i suksesit të UAMD-së për vitin akademik 2020-2021, përmendim hapjen e 5 programeve të reja studimi, 3 programe në Fakultetin e Studimeve Profesionale dhe 2 programe në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, gjithashtu janë riorganizuar 44 programe studimi, ndër to 26 programe janë riorganizuar nën masën 20% dhe 5 programe studimi në masën mbi 20% dhe është propozuar hapja e 13 programeve të reja. Riorganizimi është bërë duke pasur si qëllim kryesor ruajtjen e standarteve të cilësisë dhe duke u mbështetur në respektimin e kuadrit të ri ligjor²¹. Një risi për vitin akademik 2020-2021 është fillimi i veprimtarisë akademike me Programin e Integruar të Studimeve në Drejtësi të ciklit të dytë me kohëzgjatje normale pesë vite akademike. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e integruar e studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi.



¹⁹Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD për periudhën 2016-2020 ;Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD për periudhën 2020-2025

²⁰Ligji Nr.80/2015 ; VKM Nr.41 ,date 24.01.2018 dhe Udhëzimi Nr.31 datë 29.12.2017.

²¹VKM Nr.879 ,dt.18.12.2019 dhe Udhëzimi Nr.1 dt.14.01.2020 të MASR.

Për hapjen e programeve të reja të studimit ose në riorganizimin e programeve të studimit ekzistuese²², por edhe në përditësimin e tyre janë marrë në konsideratë objektivat kombëtarë e ndërkombëtarë të zhvillimit, si dhe janë realizuar studime tregu , me qëllim përmirësimin e ofertës akademike në funksion të plotësimit të nevojave të tregut të punës²³.



Përsa i përket mësimdhënies , ngarkesa mësimore e personelit akademik është e përcaktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi²⁴. Drejtuesit e njësisë bazë sigurojnë mbulimin me ngarkesën e plotë të të gjithë personelit akademik me kohë të plotë. Mësimdhënia e normuar vjetore, për personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme ndryshon sipas kategorive të gradave e titujve akademik, dhe angazhimit si autoritete drejtuese.

Përshkrimi, objektivat, kurrikula, syllabuset, baza legjislative e programeve të studimit si edhe kriteret e pranimit në to, publikohen në faqen zyrtare të internetit të UAMD. Ato u vihen në dispozicion studentëve edhe nëpërmjet broshurave të paraqitura gjatë Javës së Orientimit , ku studentët njihen me lektorët e tyre mentorë ,me të cilët mund të konsultohen gjatë studimeve të tyre. Syllabuset e kurseve, që përmirësohen në vazhdimësi, sigurohen lehtësisht nga studentët gjatë orës së parë të zhvillimit të kursit.

Objektivat e programeve të studimit janë të mirëpërcaktuara në dokumentacionin e dosjeve të aplikimit për hapjen e programeve të studimit²⁵ si dhe të riorganizimit të programeve të studimit si në sistemin bachelor edhe në programet master shkencor dhe profesional .

²²Relacion për riorganizimin e programit të studimit profesional (2 vjeçar); Relacion për riorganizimin e programit të studimit të “Bachelor” ; Relacion për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë “Master Shkencash”.

²³Studime të tregut të punës në dosjet e riorganizimit ose në dosjet e reja të studimit.

²⁴Norma mësimore sipas Udhëzimit të MASR-së Nr.29 , date 10.09.2018 të ndryshuar me Udhëzimin Nr.36 , date 23.11.2018 dhe Nr.37 datë 04.12.2018.

²⁵Dosje aplikimi për hapjen e programeve të studimit të çdo cikli

Këto objektiva reflektohen si në administrimin e programit të studimit dhe në syllabus²⁶, ku evidentohen qartë përshkrimi dhe objektivat e kursit. Kriteret e pranimit të studentëve në çdo cikël studimi përcaktohen qartë dhe publikohen në faqen zyrtare. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë është 3 vite akademike. Institucioni ofron studime profesionale në FSP, FTI dhe FE me kohëzgjatje normale 2 vite akademike dhe studime të integruara në FSHPJ me kohëzgjatje normale 5 vite akademike. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi është dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi ²⁷. Sipas Statutit dhe Rregullores së UAMD, studentëve u jepet vendimmarrje në përzgjedhjen e organizimit të orarit sipas preferencave të tyre. Pranë UAMD funksionon një sistem shumë efikas i menaxhimit të studentëve, i cili është sistem i mundësuar nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH), PITAGORA.

Programet e Studimit harmonizojnë kurset dhe programet e kurseve të ciklit të parë me ato të ciklit të dytë. Programet e Studimit të Ciklit të parë dhe të Dytë hartohen bazuar në Udhëzimet përkatëse të MASR²⁸. Programet e kurseve hartohen duke përfshirë një gamë të gjerë të literaturës bazë dhe alternative. Nëpërmjet faqes zyrtare në internet, Sektorit të Çështjeve Mësimore, kryhet informimi, orientimi dhe mundësohet transferimi i programeve të studimit, në përputhje me LAL, i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse.

Në funksion të ecurisë akademike dhe formuese të studentit, Institucioni vë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme, përfshirë laboratorë, biblioteka, faqe interneti me informacion të përditësuar mbi aktivitetet. Prej vitesh UAMD i ofron studentëve shërbimin e mbështetjes ndaj studentëve si dhe këshillimin e tyre për karrierën nëpërmjet Zyrës së Komunikimit, Alumni dhe Karrierës. Zyra e Karrierës është një urë lidhëse mes studentëve dhe tregut të punës , në kuadër të ofrimit të mundësive për punësim .Ajo zhvillon veprimtari, të cilat kanë për qëllim njohjen dhe afrimin e studentëve me tregun e punës, përgatitjen e tyre për t'u bërë pjesë e këtij tregu që në fazën e ndjekjes së studimeve. Si pjesë e programit mësimor organizohen ekspedita mësimore, konferenca, workshope, prezantime, takime me figura të shquara, gjyqe imituese, veprimtari të cilat janë paraqitur si aktivitete të detajuara në faqen zyrtare ne internet .

²⁶Syllabuse për programe studimi të çdo cikli

²⁷Rregullore UAMD Neni.57

²⁸Udhëzimin Nr.31, datë 29.12.2017 si dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018 E KORRIGJUAR me VKM 879 date 18.12.2019

Një eveniment i rëndësishëm, traditë e çdo viti, është Panairi i Punës, i cili ofron potenciale bashkëpunimi dhe ka si qëllim kryesor të sigurojë kontakte me rekrutuesit për të rritur mundësinë e punësimit.

Në ciklin e dytë të studimeve promovohet mësimdhënia nga lektorë me gradën shkencore “Doktor” ose me titujt akademik të kategorisë “Profesor” dhe të përzgjedhur bazuar në profilin dhe përgatitjen akademike. Gjithashtu përfaqësi nga fusha e biznesit apo fusha të tjera, janë ftuar në mësimdhënie pranë ciklit të dytë të studimeve “Masteri Profesional” për të ofruar eksperiencë dhe për të ndërtuar ura lidhëse sektor publik-privat.

Programet mësimore ²⁹organizohen për të dhënë informacion të mjaftueshëm edhe për vëzhgues të huaj. Përmbajtja e tyre është e detajuar, e organizuar në kurse semestrale dhe të parakërkuara me kodifikimet përkatëse, të vlerësuara në kredite Evropiane sipas ECTS³⁰.

UAMD, ofron programe studimesh në përputhje me Proçesin e Bolonjës, në cikle të njëpasnjëshme, (Bachelor, Master, Doktoraturë). Sistemet Universitare të ciklit të parë realizohen me 180 kredite ECTS. Institucioni ofron dhe programe të studimeve profesionale që realizohen me 120 kredite (ECTS) Studimet Universitare të ciklit të dytë përfshijnë programet Master i Shkencave dhe Master Profesional, përkatësisht jo më pak se 120 ECTS në Masterin e Shkencave dhe në Master Profesional në Mësimdhënie realizohet me 120 ECTS ndërsa programet e tjera realizohen në 60 ECTS, gjithashtu Departamenti i Drejtësisë, këtë vit akademik (2020-2021) fillon veprimtarinë akademike me Programin e Integruar të Studimeve në Drejtësi të ciklit të dytë, që do të realizohet me 300 kredite. Studimet e ciklit të tretë janë studime të Doktoraturës që zgjasin jo më pak se tri vite akademike me 60 ECTS.

Diplomat që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës në gjuhën shqipe dhe angleze³¹.


Mësimi i gjuhëve të huaja është në përputhje me politikën e ndërkombëtarizimit të studimeve. Studentët e programeve të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave dhe të ciklit të tretë kanë detyrim të dorëzojnë dëshminë e mbrojtjes së një prej 5 gjuhëve të BE-së (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtarisht.

²⁹Kurrikula për programe studimi të çdo cikli.

³⁰Sistemi Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.

³¹ Suplemente diplomash për programe studimi të çdo cikli.

Të gjitha kurrikulat e UAMD për çdo cikël studimi mund të aksesohen në faqen web të Institucionit ose duke skanuar kodin në këtë faqe.



MËSIMDHËNIA DHE KËRKIMI SHKENCORË

Janë aplikuar për herë të parë “Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore të personelit akademik dhe njësive të UAMD”. Ato janë miratuar në të gjitha nivelet dhe përfaqësojnë një listë treguesish të veprimtarisë kërkimore-shkencore të vendosur në një sistem pikëzimi.

“Kriteret...” shoqërohen me “Bazën e të dhënave të kërkimit shkencor” e cila mbahet e përditësohet në përputhje me një rregullore të veçantë (tanimë e miratuar). Ajo përfaqëson një shtet të integruar

Për monitorimin dhe vlerësimin e kontributeve të njësive bazë dhe, në total, të njësive kryesore të UAMD;


Për monitorimin dhe vlerësimin e kontributeve të çdo anëtari të personelit akademik, sipas njësive bazë dhe njësive kryesore të UAMD. Veç listës së përditësuar të kontributeve shkencore të personelit akademik dhe njësive të UAMD, baza e të dhënave për kërkimin shkencor të UAMD do të përfshijë, gjithashtu: a) listën e disertacioneve të doktoratave të mbrojtura dhe abstraktet përkatëse në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht; b) listën e punimeve të diplomës së ciklit të dytë dhe të tretë, të mbrojtura, dhe abstraktet përkatëse në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht;

UAMD ka hedhur bazat për të vlerësuar në mënyrë të standardizuar kontributet e njësive bazë të UAMD dhe personelit akademik të tij, për monitorimin në kohë reale të veprimtarisë kërkimore-shkencore, për vlerësimin periodik dhe rankimin e departamenteve dhe njësive të tjera bazë që përfshihen në vlerësimin institucional, në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015, si dhe akteve nënligjore, si:

- VKM nr. 165, datë 21.03.2018 “Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë”

- VKM Nr. 122, datë 23. 2. 2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”.

Tabela 1: Artikuj shkencorë të botuar dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare, sipas njësive të UAMD shtator 2019



Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës boton prej vitesh një periodik shkencor, revistën “Interdisciplinary Journal of Research and Development” (ISSN 2410-3411).

Ky organ shkencor është konceptuar me të drejtë si një organ ‘ndërdisiplinor’, duke u bazuar në natyrën ndërdisiplinare të UAMD dhe diversitetin e programeve të studimit.

Revista “Interdisciplinary Journal of Research and Development”³² është botuar si organ shkencor nga “Qendra për Kërkim, Zhvillim dhe Ekselencë” e themeluar në vitin 2014. Kjo theksohet në rregulloren³³ e kësaj qendre, të miratuar nga Senati Akademik³⁴.

³² <https://www.liebertpub.com/doi/abs/10.1089/jwh.2006.0129>

³³ Rregullorja e Qendrës për Kërkim, Zhvillim dhe Ekselencë

³⁴ Vendim Nr. 7, datë 22.05.2014, neni 16: Organi shkencor

Por “Qendra për Kërkim, Zhvillim dhe Ekselencë” nuk është më në strukturën e re të UAMD. Ndaj duhet rivlerësuar edhe statrusi i revistës dhe duhet marrë një vendim për vazhdimin e botimit të saj, bazuar në një traditë tanimë pesëvjeçare.

Për t’iu përgjigjur kërkesave për botime të personelit akademik të UAMD (rreth 300 pedagogë të brendshëm) duhet menduar edhe për themelimin e periodikëve të tjerë shkencorë, më të profilizuar, mundësisht sipas njësive kryesore të UAMD apo edhe njësive bazë (njëapo disa njësi).


Për këtë qëllim, tre institucione të UAMD, respektivisht Këshilli i Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, me miratimin paraprak të Rektores së UAMD prof. Dr. Kseanela Sotirifski, u kanë dërguar njësive bazë dhe njësive kryesore, si dhe gjithë personelit akademik dhe administrativ të UAMD thirrjen “Për botimin e periodikëve shkencorë”. Me këtë thirrje çdo njësi e UAMD dhe çdo anëtar i personelit akademik dhe administrativ të tij, është ftuar që të shprehë interesin për të kontribuar në botimin e periodikëve shkencorë të UAMD (revista apo buletine shkencore), të indeksuara me ISSN ndërkombëtar, e që përputhen me standardet e nevojshme për t’u përfshirë në listën e revistave shkencore që publikon Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencorë dhe Inovacionit, në muajin shkurt të çdo viti.

Bëhet fjalë, gjithsesi, për organe shkencore me standarde që përputhen me standardet shtetërore të fitimit të gradës shkencore “Doktor” dhe titujve shkencorë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor” (VKM Nr. 112, datë 23.2.2018) dhe që në të ardhmen mund të mund të shndërrohet në revistë me faktor impakti.

Mbetet që gjatë këtij viti akademik të kanalizohet interesimi i shprehur, të merren me vendime e të hartohen rregullore përkatëse mbi organe të reja shkencore, duke përcaktuar elementët e nevojshëm, si fushat, përmbajtja, gjuha, vëllimi, drejtimi dhe kohëzgjatja në detyrë e drejtuesve, kriteret e botimit dhe sistemi i referencave, financimi etj.

Tregues i rëndësishëm i performancës kërkimore-shkencore janë titujt dhe gradat shkencore të personelit akademik. Në tabelën vijuese (tabela 1), janë pasqyruar titujt dhe gradat shkencore të personelit akademik, sipas njësive bazë dhe njësive kryesore të UAMD.

Tabela 2: Titujt dhe gradat shkencore të personelit akademik sipas njësive kryesore,



Këshilli I Kërkimit Shkencor është organ vendimmarrës, që përbëhet nga përfaqësues nga të gjitha Departamentet, si dhe zv.Dekanet për kërkimin shkencor në çdo fakultet.

Përfaqësuesit e njësive bazë, përcjellin të gjithë specifikat e zhvillimit të kërkimit shkencor nga njësitë bazë në Këshillin e Kërkimit Shkencor.

Në funksion të zhvillimit, dinamizmit dhe kërkimit shkencor institucioni ndjek praktikën e mëposhtme:

- Institucioni siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore. UAMD ka lidhur 55 marrëveshje me Institucione të Arsimit të Lartë, brenda dhe jashtë vendit dhe është pjesë e 8 projekteve ndërkombëtare, Erasmus+, dy prej të cilave institucioni është lider.
- UAMD siguron ndërveprim mes institucioneve të ndryshme, të cilët funksionojnë si faktorë të rëndësishëm në fushën e edukimit, ekonomisë, kulturës, etj. Qëllimi është integrimi i kërkimit teorik me aplikimin praktik të tij. Disa nga këta institucione janë:

DAR Durrës, Këshilli i Qarkut Durrës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës, Shoqata Shqiptare e Turizmit, etj. Si të tilla, UAMD rendit 102 marrëveshje bashkëpunimi.

- UAMD rekruton personel të kualifikuar akademik në fushën e kërkimit shkencor, në funksion të strategjisë për zhvillim të institucionit, në përputhje me Rregulloren e Universitetit dhe Statutin e UAMD.

Në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies UAMD ka angazhuar pedagogë part-time nga Universitete të tjera shtetërore dhe specialistë të fushës.

Revista shkencore e UAMD “Interdisciplinary Journal of Research and Development” mund të aksesohen në faqen web të Institucionit ose duke skanuar kondin në këtë faqe.



STUDENTËT

Proçesi i pranimit të studentëve në UAMD fillon në njësitë bazë. Çdo njësi, në mënyrë kolegjiale vendos kriteret e pranimit të studentëve të rinj për çdo vit akademik. Këto kriteret i dërgohen Senatit Akademik për miratim përfundimtar. Kriteret vendosen në përputhje dhe zbatim të VKM-së së përvitshme mbi kriteret e pranimit në IAL.

Në përcaktimin e kriterëve, stafi akademik i njërive shqyrton si njohuritë që kanë mbi tregun e punës së programit përkatës, ashtu edhe njohuritë e nevojshme që duhet të ketë maturanti për të studiuar në atë program. Ato afishohen në website-in e UAMD-së, si dhe i bëhen të ditura maturanëve në panaiet apo ditët e hapura të organizuara për informimin e tyre. Informimi i studentve që në fazat para-regjistrimit, deri në diplomim e më tej, është një prioritet i institucionit. Një prej aktiviteteve më të rëndësishme është “Ditët e informimit të Maturantëve” ku igjithë stafi akademik dhe administrativ i UAMD-së, nën koordinimin e DASHA, zhvillon prezantime në gjimnazet e vendit me qëllim informimin e maturantëve.

Orientimi dhe këshillimi i studentëve në UAMD zhvillohet nga stafi akademik i çdo njësie bazë si dhe nga Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës .Zyra e Karrierës ka si funksion të saj parësor ofrimin e mundësive për vende pune, trajnime dhe praktika profesionale për studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. UAMD vendos kontakte me ndërmarrje dhe organizata të ndryshme private, të cilat veprojnë në tregun e punës.



Zyra e Karrierës zhvillon veprimtari, për përgatitjen e studentëve për t'u bërë pjesë e këtij tregu që në fazën e ndjekjes së studimeve, duke i njohur ata me mënyrat e përpilimit të jetëshkrimeve (Curriculum Vitae), të letrave të interesit (Cover Letter), përgatitjen për të zhvilluar intervista sa më të mira pune, si dhe ofrimin e një pakete të plotë këshillimi për karrierën. Këto veprimtari mundësohen në takimet dhe prezantimet me studentë apo në veprimtaritë e zhvilluara nga ndërmarrjet, që ofrojnë këshillimin e karrierës.

Këshillimi, orientimi dhe seminarët e Qendrës ndihmojnë studentët të qartësojnë qëllimet akademike dhe të karrierës, të krijojnë plane të karrierës, të zhvillojnë aftësitë e kërkimit të punës dhe të bëjnë një kalim të suksesshëm nga universiteti drejt tregut të punës. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me departamentet e Universitetit, Qendra asiston studentët në zhvillimin dhe artikulin e përvojave bashkëkurrikulare që do t'i ndihmojnë ata të jenë konkurrues në përpjekjet e tyre për të ndërtuar një karrierë të suksesshme.

Në UAMD funksionojnë aktualisht 3 biblioteka, një në secilën godinë, me kapacitet rreth 200 vende së bashku. Fondi i bibliotekave përbëhet nga literaturë e printuar dhe elektornike. Nga të dyja kategoritë kemi tituj në gjuhën shqipe dhe atë të huaj. Në përzgjedhjen e literaturës së detyruar të lëndës përkatëse, çdo lektor sigurohet se kjo literaturë do të jetë e disponueshme për studentët në një prej bibliotekave.

Në UAMD zbatohet një program mentorimi për studentët e ciklit të parë dhe të dytë. Mentorimi ka si qëllim kryesor: asistimin, këshillimin, mbështetjen e studentëve në lidhje me problemet që mund të paraqiten gjatë viteve të studimit, si dhe përpjekjen për të maksimizuar rritjen dhe zhvillimin e studentëve në fushën akademike, atë profesionale e më gjerë.

Gjatë periudhave të praktive mësimore si dhe për përgatitjen e temës së diplomës bachelor dhe mikrotezës së masterit, çdo student i caktohet një lektor udhëheqës. Udhëheqësi orienton studentin mbi autorët dhe literaturën që ka në dispozicion për temën përkatëse dhe mbikëqyr punën e studentit për të arritur një punim sa më cilësor dhe një rezultat sa më të lartë akademik.

Nisur nga "Pakti për Universitetin" të gjithë studentët e UAMD-së do të pajisen me Kartën e Studentin për të përfitur nga lehtësirat që kjo kartë ofron. Të mbështetur nga stafi akademik dhe administrativ i universitetit, studentët e UAMD-së janë të angazhuar në disa struktura. Për aktivitetekulturore studentët organizojnë: Klubin e Librit, Klubin e Artit,

Klubin e Debatit, Klubin e Multimedias dhe Fotografisë, Klubi i Juristëve të Rinj. Ndërsa për aktivitetet sportive ato kanë krijuar: Ekipin e Futbollit, Ekipin e Basketbollit, Ekipin e Futsalit, Ekipi i Volejbollit Meshkuj/Femra si dhe Klubin e Shahut.

UAMD është tashmë pjesë e Federatës Shqiptare të Sportit Universitar, e cila ka gjithashtu marrëveshje me Federatën e Sporteve Universitare të Kosovës, me qëllim organizimin e kampionateve të përbashkëta.

Dita e diplomimit ose përfundimi i një cikli studimor dhe kërkimi i punës tuaj të parë, shenjojnë fillimin e një faze të re dhe të rëndësishme në jetën tuaj.

RISI për vitin akademik 2019-2020, për shkak të situates aktuale të pandemisë, u vendos nga Rektorati I UAMD-së realizimi i ceremonisë së diplomimit online, në mënyrë që studentët të mos të humbisnin një nga ditët më të lumtura .



(Ceremonia e Diplomimit)

Shërbimet ndaj studentëve – Sekretaria Mësimore

Sekretaria Mësimore është njësi administrative përgjegjëse për rregullimin, ndjekjen dhe arkivimin e çdo regjistrimi, të dhëne, dokumenti apo listë notash që lidhet me studentin për programet e studimit të ciklit të parë dhe për programet e studimeve të ciklit të dytë. Sekretaria mësimore drejtohet nga Kryesekretarja e cili koordinon dhe mbikqyr punën. Çdo sekretari mësimore e njësisë kryesore është në varësi të Dekanit përkatës. Puna e sekretarive rregullohet nga një rregullore e veçantë ose sipas dispozitave specifike në rregulloren e Institucionit dhe Fakultetit.

Shërbimet që sekretaria mësimore ofron për studentë janë:

- kryen regjistrimin e kandidatëve fitues
- hap dhe ruan dosjen personale për çdo student, ku pasqyrohen dokumentacioni i regjistrimit të studentit në institucion, lëndët dhe vlerësimin deri në përfundim të ciklit mësimor, rezultatet e provimeve
- administron në formë shkresore listat e rezultateve të provimeve të cilat vijnë nga lektorët në format elektronike bazuar në sistemin e menaxhimit
- përgatit transkripte (listë notash) për studentin
- përgatit dokumente të cilat i dorëzohen institucioneve zyrtare si:
 - a) Vërtetim Studenti
 - b) Rekomandime
 - c) Dokumente të tjera të ngjashme
- plotëson diplomat e studentëve, të cilët kanë fituar të drejtën për t'u diplomuar
- dorëzon diplomën studentëve të diplomuar kundrejt firmës
- ndjek procedurat e studentëve të cilët duan të ndërpresin studimet universitare, kryen ç'rregjistrimet
- evidenton studentët të cilët nuk kanë arritur të përfundojnë me sukses studimet brenda afatit maksimal të përcaktuar në aktet ligjore dhe ia përcjell Dekanit

Pranë sekretarisë mësimore studenti mund të marrë informacion mbi programin e studimit, programin e lëndës (syllabus), orarin dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm.

Në vitin akademik 2019-2020 nis në UAMD programi i trajnimit të detyrueshëm përgatitor i shkollës së drejtorave

Në Fakultetin e Edukimit në datën 16 tetor 2020 u mbajt ceremonia për fillimin e Programit të Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për Drejtues të Institucioneve Arsimore të Arsimit Parauniversitar. Shkolla e Drejtorëve fillon për herë të parë në Durrës për brezin e 2-të të aplikantëve për drejtorë në detyrë dhe aspirantë për drejtorë shkolle ku zhvillojnë mësimin dy grupet me nga 26 anëtarë secili. Pjesëmarrësit në Shkollën e Drejtorëve do të trajnohen nga ekspertët vendas si anëtarë të stafit të Fakultetit të Edukimit dhe nga ekspertë të huaj mbi modelet më të suksesshme të lidërshiptit në shkollë, pasi programi ofrohet i ndërtuar mbi modelin e Institutit “Avney Rosha” në Izrael, duke u përshtatur dhe bazuar në nevojat e kontekstit shqiptar. Pjesëmarrësit në Shkollën e Drejtorëve do të trajnohen nga ekspertët vendas si anëtarë të stafit të Fakultetit të Edukimit dhe nga ekspertë të huaj mbi modelet më të suksesshme të lidërshiptit në shkollë, pasi programi ofrohet i ndërtuar mbi modelin e Institutit “Avney Rosha” në Izrael, duke u përshtatur dhe bazuar në nevojat e kontekstit shqiptar. Angazhimi maksimal ndaj këtij programi nuk buron vetëm nga detyra individuale dhe institucionale që është marrë përsipër, por lind para së gjithash nga dëshira dhe përpjekja fisnike për të dhënë kontributin tonë në të mirë të arsimit, shoqërisë dhe vendit. Ky program është një mision që na është besuar për të vendosur edhe ne një gur në ndërtimin e një sistemi arsimor të bazuar në vlera dhe kontribute, duke vlerësuar rëndësinë dhe ndryshimin që do të sjellë në drejtim ky program, i cili do të ndikojë në të nxënësit dhe motivimin e stafit për të ndikuar tek nxënësit duke sjellë kështu përmirësimin e dëshiruar në vitet në vijim.



(Takim me përfaqësues të Shkollës së Drejtorëve në lidhje me projektin e fituar)

Shërbimet ndaj studentëve – Biblioteka

Biblioteka u krijua në fund të vitit 2007 dhe ka aktualisht në fondin e saj **rreth 12 000 tituj** ne gjuhën shqipe dhe të huaj. Fondi shqip dhe i huaj mbulon gjithë fakultetet e universitetit. Literatura është bashkëkohore, kryesisht shkencore dhe e **rifreskuar** për periudhën 5-10 vjeçare. Pjesë e koleksioneve është periodiku shqip i viteve 1944-2003. Biblioteka është e abonuar në një sërë revistash shkencore në format shkresor dhe elektronik, duke siguruar një pasurim të vazhdueshëm të fondit të saj.



Biblioteka është e ndarë në funksion ë fakultetit që mbulon. Biblioteka Nr.1, pranë godinës në Currila mbulon FSP dhe FTI. Biblioteka Nr.2, pranë kampusit të ri mbulon FSHPJ, FB dhe FE. Si një bibliotekë me fonde të hapura dhe hibride, ajo mundëson kërkim të informacionit on-line, në sallën e leximit, skedarë elektronikë, lehtësira në kërkimin bibliografik të informacionit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike dhe pranë kompjuterave të sallës. Biblioteka e Universitetit “ Aleksandër Moisu”përfaqësohet gjithashtu në Bibliotekën Virtuale të Shqipërise: “COBIB.AL”. Baza e të dhënave COBIB.AL është e një rëndësie thelbësore për sistemin COBISS.AL (sistemi bibliografik kombëtar për vlerësimin e rezultateve të kërkimit në Shqipëri), sepse ka rol qendror në sistemin e katalogimit të përbashkët, në kërkimin e informacioneve bibliografike dhe në udhëheqjen e bibliografive të

kërkuesve shkencore shqiptare. Baza përmban regjistrime bibliografike për materiale libra (monografi, seriale, artikuj) dhe jolibra (CD, DVD etj.),

Si anëtare e Konsorciumit të Bibliotekave Akademike në Shqipëri dhe përmes projektit ERA2012 (Electronic Resources for Albania), lexuesit përfituan akses në një gamë të gjerë të burimeve elektronike me tekst të plotë me cilësi të lartë. Përmes projekteve Tempus, fondi u pasurua me titujt më të fundit shqip, anglisht që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm.


Vitin akademik 2018-2019 Biblioteka e UAMD vjen me një risi shumë pozitive edhe për studentët e masterit që tashmë do e kenë më të lehtë ta frekuentojnë edhe gjatë ditës së shtunë.

Orari i shërbimit të përdoruesve :

e hënë- e shtunë: 8:00- 16:00

Shërbimi i informacionit elektronik (me e-mail/katalog elektronik)

e hënë- e diel : 8:00-20:00



Lidershipi Studentor

Përmes lidershipit studentor UAMD dëshiron të forcojë kapacitetet studentore dhe të promovojë përfshirjen dhe angazhimin e tyre në jetën universitare. Për këtë UAMD organizon aktivitete që ndihmojnë studentët të menaxhojnë më mirë jetën studentore dhe ndërveprojnë me njëri tjetrin për të arritur qëllime të përbashkëta. Të ndërmarrësh nisma nuk ka qenë asnjëherë kaq e lehtë në UAMD. Çdo student ka mundësinë dhe inkurajohet t'i bashkohet njërit prej klubeve studentore të përmëndura më poshtë:

Klubi i Librit

- Klubi i Artit
- Klubi i Debatit
- Klubi i Multimedias dhe Fotografisë
- StartUp UAMD
- Klubi për Shoqëri të Ndjeshme
- Klubi i Juristëve të Rinj
- Klubi Diplomatik
- Klubi i Shahut
- Ekipet sportive

Ekipi i Futbollit

- Ekipi i Futbollit
- Ekipi i Basketbollit
- Ekipi i Volejbollit Meshkuj/Femra
- Ekipi i Futsalit



PIKA TË FORTA TË INSTITUCIONIT

➤ Mundësitë

- Të rritet efektiviteti i bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në studime dhe kërkimin shkencor.
- Të ketë përfitime nga grantet kërkimore ku mund të përfshihen dhe angazhohen edhe studentët.
- Të mundësohet transformimi i universitetit në një aktor të zhvillimit rajonal dhe kombëtar.
- Të mundësohen dhe realizohen marrëdhënie bashkëpunimi me bizneset dhe grupet e tjera të interesit.
- Të mundësohet hapja e programeve të reja dhe fleksibël të studimit.

➤ Organizimi institucional

- Organizimi dhe funksionimi i institucionit është realizuar dhe zbatohet në përputhje me parashikimin e statutit dhe rregulloreve të tij të brendshme.
- Institucioni duke pasur një strukturë të brendshme autonome, ka bërë dhe bën përpjekje të vazhdueshmepër ndërkombëtarizimin e aktivitetit të tij mësimor dhe shkencor, përmes marrëveshjeve të suksesshme me institucione të tjera, kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Vendimmarrja institucionale bazohet në organe kolegjinale, të ngritura sipas legjislacionit, duke garantuar në këtë mënyrë pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të institucionit si edhe objektivitet e transparencë në vendimmarrje.
- Realizimi me sukses i akreditimit institucional të universitetit dhe puna e vazhdueshme për akreditimin e të gjitha programeve të studimit.

➤ Burimet

- Funksionet dhe detyrat e organeve akademike dhe administrative, si dhe përshkrimet e punës për çdo pozicion janë përcaktuar qartë nëpërmjet rregulloreve përkatëse të institucionit, duke siguruar kështu menaxhimin efikas të aktivitetit të tij.
- Sistemi i informimit të institucionit është i mirëorganizuar dhe efektiv, i cili u mundëson studentëve dhe personelit sigurimin e një informacioni të plotë rreth procesit akademik dhe administrativ.
- Institucioni gëzon pasuri të paluajtshme dhe mjedise kampusi universitar, duke siguruar një infrastrukturë të përshtatshme për organizimin e

veprimtarisë akademiko-shkencore, si edhe angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për ndjekjen dhe përmirësimin e tyre.

- Stafi akademik efektiv duke pasur një nivel kualifikimi në rritje, përbënnjë pikë mjaft të fortë, i cili garanton implementimin me sukses të programeve në të gjitha ciklet e studimit.

➤ Kurrikula cilësore dhe fleksibël

- Mundësimidhe sigurimipër një përgatitje e formim cilësor teorik nëpërputhje me kërkesat e tregut.
- Organizimi i programeve të studimit me objektiva të përcaktuara qartë,bën të mundur që ato të jene lehtësisht të kuptueshme dhe të arritshme.
- Ngarkesa mësimore e stafit akademikbëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet nënligjore në fuqi.
- Vlerësimi dhe zhvillimipolitikave mbështetëse nga institucioni për ecurinë dhe mbarëvajtjen e studentëve.
- Organizimi i programeve akademike u mundëson studentëve të praktikojnë aftësitë teorike dhe të përgatitenpë të qenë të aftë në tregun e punës.
- Mundësimi i vlerësimit cilësor të dijeve teorike dhe praktike të studentëve, nëpërmjet provimeve te ndërmjetme dhe përfundimtare përgjatë fazave të kontrollit të dijeve, sipas një sistemi unik i ndërtuar dhe bazuar në eksperiencën e universiteteve amerikane.
- Cilësia e programeve të studimit dhe aplikimi që në hapje e Kartëssë Bolonjës për mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve, ka mundësuar ndër vite që shumica e ish studentëve të UAMD, të ushtrojnë profesionin dhe të japinkontributin e tyre në institucion, duke qenë pjese e stafit akademik të Fakulteteve të Universitetit, si edhe ne universitetet e tjera brenda vendit, ose të punojnë në institucione e kompani te ndryshme.
- Përdorimi i metodave interaktive dhe efektive,orientimi drejt risive dhe inovacionit në mësimdhënie e kërkimin shkencor, ka mundësuar krijimine një qasje ndaj studenteve, duke i ndihmuar në mësimnxënie, në kuptimin konceptual te situatave komplekse me karakter ekonomik dhe jo vetëm, krijimin e aftësive krijuese për të gjeneruar ide te reja mbi teoritë, produktet, njohuritë etj.
- Studimi i tregut nga departamentet e fakultetevetë Universitetit, mundëson hapjen e programeve të reja të studimit nëpërshtatje më të

mirë ndaj kërkesave të tregut, si dhe do të ndikojë pozitivisht në preferencat e studentëve të të dy cikleve të para të studimit.

➤ **Infrastrukturë moderne**

- Godinat e reja të ndërtuara në kampusin universitar sigurojnë një rishpërndarje më efikase të hapësirave fizike, të cilat ndikojnë pozitivisht në një shfrytëzim më efikas të orarit mësimor ditor, duke mundësuar kështu hapësira të lirakohoredhe facilitete për studentët.

➤ **Partneritetet**

- Stafi akademik i universitetit ka patur dhe vazhdon të ketë në mënyrë të vazhdueshme mundësi të shumta trajnimi dhe shkëmbimi eksperiencash me IAL partnere brënda dhe jashtë vëndit.
- Studentët kanë mundësinë të zhvillojnë eksperiencë të reja, të larmishme, në saj të programeve të ndryshëm si Erasmus +, duke iu ofruar mundësia të frekuentojnë studimet për një semestër në disa IAL më të mira të Bashkimit Europian.
- Universiteti ka siguruar nërkombëtarizimin e tij, duke qenë pjesë në shumë projekte të larmishme evropiane.

➤ **Praktikat mësimore**

- Mundësimi dhe siguri i marrëveshjeve të shumta të politikave të bashkëpunimit të universitetit me institucione të tjera, i jep studentëvetë UAMD-së, mundësinë e përzgjedhjes së institucioneve më të mira për të realizuar praktikat mësimore.

➤ **Staf i kualifikuar**

- Trendi pozitiv në kualifikimet e stafit të UAMD-së ndër vite, nëdrejtim të marrjes së gradave shkencore dhe titujve akademikë, por jo vetëm.
- Komunikimi efektiv dhe produktiv studentë-pedagog.
- Rritja e vazhdueshme e mobilitetit të stafit akademik.
- Pjesëmarrja gjërë dhe aftësimi i stafit akademik në procesin e kërkimit shkencor, si edhe angazhimi i vazhdueshëm i pedagogëve në botime e studime shkencore, në organizimin periodik të konferencave shkencore, botimin e monografive, artikujve shkencorë, teksteve mësimore apo studimeve të realizuara prej tyre, etj.

➤ Punësimi

- Puna dhe bashkëpunimi i zyrës së ALUMNI-t dhe stafit akademik, të cilët ruajnë në mënyrë të vazhdueshme kontakte me komunitetin e biznesit dhe studentët, mundësojnë sot disponimin e statistikave të besueshme mbi rezultatet pozitive të punësimit të të diplomuarve në UAMD.
- Rritja profesionale e stafit të sektorit të Karrierës dhe ALUMNI-t nga pjesëmarrja në projekte të rëndësishme për zhvillimin e karrierës ku UAMD bën pjesësiç janë: trajnimet e stafit nga Risi Albania dhe GRADUA (Erasmus +) një projekt që synon të krijojë në Shqipëri një platformë inovative të bazuar në IT për ndjekjen e të diplomuarve, si dhe punësimin e tyre, në mbështetje të hartimit të politikave dhe reformës së arsimit të lartë.

➤ Aktivitete në shërbim të studentëve

- Stafi akademik i çdo fakulteti në UAMD ofron një program të larmishëm aktivitetesh me karakter social dhe edukativ, me fokus studentët, me qëllim ngjalljen e interesit në funksion të procesit mësimor, si edhe thellimin e njohurive përmes të ftuarve dhe personaliteteve të shquara nga fusha të ndryshme të biznesit, shkencës, artit etj.

➤ Rekomandime për rritjen e cilësisë në UAMD

- Të përfshihet praktika profesionale në të gjitha programet eciklit të parë të studimit bachelor, për të plotësuar ato kurrikula ku praktika nuk është e detyrueshme.
- Të krijohet një mekanizëm mentorimi si në IAL të ndryshme të sistemit Anglosakson (Faculty to faculty mentoring), me anë të të cilit, stafi akademik i kategorise “Profesor” dhe “Lektor” të garantojë cilësinë e stafit akademik të kategorisë asistent lektor.
- Të përmirësohet cilësia e mësimdhënies nga pedagogët të vlerësuarjopozitivisht nga studentët, përmes instrumentave dhe treguesve të matshëm.
- Të ketë një rifreskim të vazhdueshëm të literaturës bazë dhe asaj ndihmëse për çdo lëndë, me literaturën bashkëkohore.
- Të mundësohet organizimi dhe zhvillimi i studimeve të vazhdueshme të tregut me të dhëna sasiore dhe cilësore nga UAMD, në bashkëpunim të

ngushtë me partnerët e saj, me qëllim që të realizohen ndryshimet e nevojshme në kurrikulat e programeve të studimit.

- Të përfshihen lëndë në gjuhën angleze edhe në ciklin e dytë të studimit master, me qëllim që studentët të adaptohen më lehtë me tregun e huaj të punës.
- Të mundësohet dhe të ketë një shtim e zgjerim të shërbimeve infrastrukturore komplementare në funksion të studentëve si: mensë, konvikte apo shërbime të tjera ndihmëse.

